

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 SHKURT 2003**

T R A N S K R I P T

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 13. 02. 2003.GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Bankrotim
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Farërat
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Pyjet e Kosovës
6. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrës të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВН РЕД

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
3. Прво разматрање Нацрта закона о ликвидирањи и Реорганизацији Правних лица у Банкротству
4. Прво разматрање Нацрта закона о Семену
5. Друго разматрање Нацрта закона о Шумама Косова



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

6. Postavljawe pitanja

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се оћекује одговор”
(Правило 19.2 са Привремени пословник)

AGENDA

1. Agenda agreed
2. Minutes of previous meeting
3. First reading of Draft Low on Liquidation and Reorganization of Legal Persons in Bankruptcy
4. First reading of Draft Low on Seeds
5. Second reading of Draft Low on Forests
6. Questions

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 19.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 SHKURT 2003

Seanca filloi punën në orën 10,00.

Seancën plenare e kryesoi akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues i seancës Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare. Më lejoni që të përshëndes pjesëmarrjen e të gjitha grupacioneve politike në Parlament, që do të thotë se jemi në përbërje të plotë dhe mirë se kthehet koalicioni "Kthimi" në Parlament. Iu dëshiroj punë të mbarë në proceset e zhvillimeve që na presin në Kosovë. Shpresoj se rendin e ditës me kohë e keni marrë.

Por, para se ndokush të kërkojë ndryshimin e rendit të ditës, kam për obligim ta jap një sqarim të vogël. Të gjithë jemi të informuar se kohë më parë në Parlament është ngritur një nismë e 42 deputetëve, nismë kjo e cila konsiderohet legjitime dhe konform të gjitha rregullave të punës në Parlament. Megjithëse është bërë një punë shumë e madhe, këtë po e them më tepër për opinionin jashtëparlamentar, meqë është krijuar njëfarë hutie. Kryesia e Parlamentit, në seancën e vet të fundit, ka proceduar për një seancë plenare të rregullt dhe me rend dite të rregullt me ç'rast janë zhvilluar biseda dhe diskutime intensive në mes grupeve parlamentare dhe është arritur, sipas informacioneve që kam, një përfundim i përbashkët i katër grupeve gjegjësisht shefave të grupeve parlamentare: udhëheqësit të Grupit Parlamentar të LDK, profesor Sabri Hamiti, udhëheqësit të Grupit Parlamentar të PDK, zotit Fatmir Limaj, udhëheqësit të Grupit Parlamentar të AAK, zotit Bujar Dugolli dhe i udhëheqësisë së Grupit Parlamentar të grupeve etnike joserbe dhe atë marrëveshje që kanë arritur bashkërisht këto grupe dhe për të mos vazhduar me debat të mëtutjeshëm dhe t'i kthehemi rendit të ditës, më lejoni që ndihmësi im tani, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Hydajet Hyseni t'ia paraqesë Parlamentit dhe ta bëjë sqarimin lidhur me të.

HYDAJET HYSENI:

KUVENDI I KOSOVËS
Prishtinë, më 13 shkurt 2003.

DEKLARATË

E PËRBASHKËT E KRYETARËVE TË GRUPEVE PARLAMENTARE TË LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, TË PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS, TË ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS DHE TË MINORITETEVE TJERA NË LIDHJE ME NISMËN E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR KOSOVËN SHITET SOVRAN DHE TË PAVARUR TË DATËS 3 SHKURT 2003

Kryetarët e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës, u pajtuan me sa vijon:

1. Përkrahim nismën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën shtetë sovran dhe të pavarur, të datës 3 shkurt 2003.
2. Nisma e deputetëve ka hyrë në procedurë të rregullt në Kuvend dhe vazhdon shqyrtimi i saj.
3. Kryetarët e grupeve parlamentare marrin përsipër harmonizimin e qëndrimeve për Deklaratën e pavarësisë me grupet parlamentare dhe me institucionet tjera të pushtetit në Kosovë.
4. Deklarata e harmonizuar do të dalë për miratim në ndonjërin nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës në procedurë të rregullt në bashkëpunim të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të Kryesisë së Kuvendit.

GRUPI PARLAMENTAR LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS,
Sabri Hamiti, kryetar

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS,
Fatmir Limaj, kryetar

GRUPI PARLAMENTAR I ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS,
Bujar Dugolli, kryetar

GRUPI PARLAMENTAR I MINORITETEVE TJERA,
Haxhi Zylfi Merxha, kryetar

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zoti Hyseni. Besoj se rendi i ditës miratohet? Urdhëroni zoti Kelmendi.

MUHAMET KELMENDI:

I nderuar zoti kryetar, zonja dhe zotërinjë,

Natyrisht se përshëndes kërkesën ose qëndrimin të cilin e lexoi anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, por mendoj se në tri çështje deklarata e tillë është në kundërshtim me tërë procedurën që udhëhiqet Kuvendi i Kosovës.

Së pari, nuk është nismë, por është kërkesë e shtruar nga ana e 42 deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të dalë në seancë çështja e shpalljes së pavarësisë dhe e shtetit të Kosovës.

Së dyti, shqyrtimet duhet të zhvillohen dhe mund të zhvillohen vetëm pas një diskutimi të hapur dhe të çiltër këtu në seancën të Kuvendit të Kosovës, ku të gjithë deputetët të shprehin mendimet dhe pastaj mund të krijohet komision i veçantë që merret me çështjen e tillë ose mund t'u jipet udhëheqësve të grupeve parlamentare për ta bërë harmonizimin e qëndrimeve. Por nuk mendoj se, pa caktuar seancën dhe pa diskutim në Kuvend këtu, mund të bëhet ndonjë harmonizim i mendimeve në qoftë se nuk dëgjohen mendimet e drejtpërdrejta të të gjithë deputetëve që janë prezent dhe që janë anëtarë të Kuvendit të Kosovës.

Së treti, Kuvendi i Kosovës nuk ka të drejtë, dhe aq më pak Kryesia, që të marrë në shqyrtim çështjen e kërkesës së paraqitur nga ana e një të tretës së deputetëve. Sepse, kërkesa nuk u paraqitur dhe nuk mund të shqyrtohet në Kuvend dhe Kryesi: – a të dalë në seancë apo mos të dalë në seancë, por është një kërkesë juridikisht e lejshme, e përcaktuar në Kornizë ndonëse në formë jo të qartë, por në Rregullore domosdo dhe është në proceset demokratike që kur një kërkesë prej një të tretës së deputetëve paraqitet në mënyrë urgjente dhe brenda afatit të caktuar pa e kaluar shtatëditëshin, kështu edhe është në vende të ndryshme të botës, duhet domosdo të organizohet seanca e Kuvendit, të hapen diskutimet dhe pastaj të shkohet drejt zgjidhjes së formës dhe vendosjes me votën e lirë të të gjithë deputetëve. Është tjetër pastaj çka do të vendosshim ne, dhe ne natyrisht kemi tri forma të vendosjes:

1. Me shpallë pavarësinë, gjë që është e drejtë e këtij Kuvendi, sepse Kuvendi është dalë nga vota e lirë e qytetarëve të Kosovës,
2. Me refuzuar, në qoftë se shumica do të jetë kundër, dhe
3. Me pranuar referendumin e vitit 1992, kur populli ka shpreh vullnetin e vet për shtet të pavarur e sovran, por nuk është shpallur pavarësia për shkak se Kuvendi, atëherë, nuk është organizuar, nuk është thirrur seanca dhe atë vullnet të popullit nuk ka pasur kush ta shpallë zyrtarisht si vullnet të popullit të Kosovës.

Prandaj, zonja dhe zotërinjë, mendoj se çështja e tillë duhet të kapet në këtë anë dhe mendoj se duhet domosdo të dilet në seancë çështja ashtu që deputetët, në mënyrë të lirë dhe të çiltër të diskutojnë dhe pas shprehjes së mendimeve të vendosin përfundimisht.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Nuk ka diskutime tjera. Procedojmë me rendin e ditës.

Më lejoni që para se të kalojmë në miratimin e procesverbalit, t'i dëshiroj mirëseardhje Kryeministrit dhe punë të mbarë atij dhe Qeverisë në Kuvend të Kosovës.

A ka kush vërejtje në procesverbal apo po e praktikojmë si deri tani, ata që kanë sygjerime apo vërejtje, t'i japin me shkrim në mënyrë që të inkorporohen në dokumentacionin valid të Kuvendit. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim.

Lus ministrin përkatës, ose Kryeministrin të na bëjnë nderin në veçanti. Zoti kryeministër, foltorja është juaja.

KRYEMINISTRI BAJRAM REXHEPI:

I nderuar kryetar, e nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Meqenëse iniciativa për këtë Projektligj ka qenë nga Kryeministria, atëherë më ka ra obligim që unë ta bëj prezentimin e pikave kryesore lidhur me Projektligjin për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim.

Situata e rëndë, e trashëguar nga e kaluara, e sidomos e diktuar nga lufta e fundit në Kosovë, ka ndikuar në krijimin e një gjendjeje të rëndë ekonomike dhe sociale. Sipas sondazheve dhe hulumtimeve të cilat janë bërë kohëve të fundit Kosova gjendet në krye të listës së vendeve ekonomikisht më të prapambetura. Për ta argumentuar këtë fakt, mjafton t'i hidhet një vështrim nivelit të lartë të papunësisë dhe numrit, po ashtu, të madh të personave dhe familjeve të cilat jetojnë në kushte të rënda sociale. Situata e tillë, shumë e rëndë për momentin, na obligon që ne si Qeveri dhe Kuvend të bëjmë angazhim maksimal që ta pajisim Kosovën me infrastrukturë të nevojshme ligjore për një zhvillim të shpejtë e të papenguar të biznesit, bazuar në ekonominë e tregut të lirë e cila do të mundësojë daljen e vendit nga prapambeturia ekonomike dhe gjendja e rëndë sociale.

Nuk ka dyshim se kësaj do të kontribuojë shumë aprovimi i Projektligjit që sot kemi në shqyrtim. Në drejtim të arritjes së këtyre qëllimeve, Projektligji mbi likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim siguron:

- a) bazën ligjore mbi të cilën do të mbështetet likuidimi dhe riorganizimi i personave juridikë që kanë probleme në zhvillimin e aktivitetit të tyre afarist.
- b) juridiksionin e subjektit, i cili do të vendosë mbi likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim, procedurën dhe çështjet tjera që u referohen këtyre problemeve;
- c) trajtim të barabartë për të gjitha palët të cilat janë të përfshira apo të prekura me çështje të likuidimit dhe riorganizimit;
- d) zhvillimin e një ekonomie të shëndoshë të bazuar në tregun e lirë dhe konkurrencën lojale;
- e) përmbushjen e obligimeve që dalin nga Korniza kushtetuese të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e tij, me legjislacionet, standardet, e normat relevante evropiane ndërkombëtare;
- f) ofron mjete efikase juridike për mbrojtjen e interesave të ligjshme të kreditorëve, debitorit, personave tjerë që ndikohen nga procedura e likuidimit dhe riorganizimit dhe të shoqërisë në tërësi;
- g) qasje të avancuar të Kosovës drejt integriteteve të mirëfillta evropiane e ndërkombëtare.

Bazuar në faktin se krijimi i një ekonomie të shëndoshë është njëri prej kushteve themelore për këto integritete, në këtë drejtim, me këtë ligj, në mënyrë të detajizuar rregullohet:

- a) çështja e fillimit të procedurës së riorganizimit dhe likuidimit të personave juridikë në bankrotim:

Duke u nisur nga bazat e paraqitjes së kërkesës, përmbajtja, pranimi dhe prapsimi i saj, kompetencat e gjykatës, pushteti administrativ, mbyllja e rastit, dispozitat ndëshkimore e tjerë.

Detyra e gjykatës që pas pranimit të rastit të bankrotimit të emërojë një administrator i cili do të marrë në posedim pasurinë e debitorit, do të udhëheqë me atë dhe do të kujdeset për mbrojtjen e interesave të të gjitha palëve në procedurë.

Formimi i bordit të kreditorëve si një trup i rëndësishëm për një zhvillim të drejtë e efektiv të procedurës.

Sipas Projektligjit objekt i procedurës së likuidimit gjegjësisht riorganizimit është e gjithë pasuria që ka debitori në kohën e paraqitjes së kërkesës dhe atë: pasuria e lujtshme dhe e paluajtshme; materiale dhe jomateriale, kudo që gjendet ajo.

Për t'u ikur keqpërdorimeve të mundshme, Ligji rregullon edhe çështjen e kufizimit të bartjes së pasurisë së debitorit: sekuestrimin, inventarizimin, pasurinë që është në transport, pra tranzit, e tjerë.

Pra, Ligji me dispozita të shumta parasheh mbrojtjen efikase të interesave të debitorit në rastet kur janë në pyetje kërkesat joreale dhe ...(!!!)... inekzistente parashtruara nga kreditorët e papërgjegjshëm apo kreditorë të paqenë.

Për përgatitjen e këtij Projektligji, janë angazhuar ekspertë të njohur vendorë e ndërkombëtarë, si dhe është koordinuar puna edhe me Zyrën ligjore të UNMIK-ut.

Për t'u bindur se është i rëndësishëm ky ligj për Kosovën, mjafton të theksohet fakti se miratimi i këtij ligji paraqet njërën nga portat kryesore për t'u filluar procesi i privatizimit, si një proces i ligjshëm dhe i domosdoshëm për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit, si dhe rekomandimi i Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar se pa aprovimin e këtij ligji, Kosova do të qëndrojë larg agjendave të këtyre institucioneve botërore për të pasur mundësi për të thithur ndihma e kredi komerciale.

Prandaj, të nderuar deputetë, është koha të aprovohet ky ligj, sepse e kemi borxh moral, intelektual, institucional, politik e kombëtar që t'i sigurojmë popullit të këtij vendi një të ardhme më të mirë dhe më sigurtë.

Në fund kisha dashur edhe një herë të përmend se shumica e ndërmarrjeve shoqërore do t'i nënshtrohen bankrotimit për arsye se do të jetë si një bazë e fillimit të privatizimit. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti kryeministër ju falemnderit. Projektligji është në shqyrtim të parë.

Hap debatin në parim.

Me kohë ju janë shpërndarë materialet e këtij projektdokumenti, prandaj lus deputetët, ata që janë të përgatitur dhe kanë studiuar ligjin, të urdhërojnë ta marrin fjalën.

E ka fjalën zonja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI:

Deputetë të nderuar,

Sdomend se Ligji, të cilin Kryeministri e elaboroi dhe arsyetoi, është një ndër ligjet më të rëndësishme për ekonominë e Kosovës. Mirëpo, unë ose nuk e kam pa ose nuk ekziston në tekstin e Projektligjit se cilat janë subjektet ekonomike, të cilat do t'i nënshtrohen falimentimit, përkatësisht a do t'u pranohet subjekteve ekonomike statusi i personit juridik që e kishim përpara dhe që ishin të regjistruara në regjistrin e subjekteve

të gjykatës ekonomike të qarkut, apo do t'i nënshtrohen vetëm ato ndërmarrje apo kompani të tjera që janë të regjistruara sipas rregullores në regjistrin e komunave, si licencë për biznes. Këtu ka mbet një paqartësi që sigurisht nëpër komisione do të diskutohet dhe do të ketë amendamente, sepse vërtetë duhet të dihet përpara se a ka ndonjë subjekt ekonomik statusin e personit juridik për t'iu nënshtuar falimentimit. Në të kundërtën, nuk mund t'i nënshtrohet falimentimit një subjekt i cili nuk ka statusin e personit juridik.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zonja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Ligji i propozuar për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim mbështetet në standardet më të larta ndërkombëtare lidhur me procedurën gjyqësore për likuidimin e detyrueshëm të një ndërmarrjeje ose personave tjerë juridikë që rrjedh nga paaftësia paguese apo insulvenca e debitorit e cila synon vlerësimin e pasurisë së ndërmarrjes së falimentuar me qëllim të përmbushjes së detyrimit ndaj kreditorëve. Ligji ofron mjete efikase juridike për mbrojtjen e kreditorëve me rastin e likuidimit apo riorganizimit të personave juridikë. Ligji i propozuar është i një rëndësie të veçantë për shkak se për herë të parë Kosova do të ketë Ligjin e mëvetësishëm për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim.

Nga ana tjetër, me anë të këtij ligji, zhvlerësohen dispozitat juridike të ligjeve të aplikuara që kanë rregulluar këtë materie në Kosovë, konkretisht, Ligji mbi barazimin me dhunë dhe falimentimin "Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 15/65, me ndryshimet dhe plotësimet nr. 55/69, 39/72, 16/74 dhe ai i fundit 84/89. Në këtë aspekt Ligji arrin që t'i eliminojë zbrastësitë juridike që kanë përcjellur Kosovën e pasluftës në këtë sferë.

Me anë të këtij ligji krijohet një kornizë adekuate ligjore, ku përfshihen:

Së pari, kushtet për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në falimentim;
Së dyti, procedurat për likuidimin, dhe
Së treti, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të përfshirë në këtë procedurë.

Ligji i propozuar, përnga aspekti i rëndësisë së ekzistimit dhe implementimit të tij, është shumë i nevojshëm në drejtim të plotësimit të zbrastësive juridike, duke siguruar kështu një shtet me zhvillim të një ekonomie të shëndoshë, të bazuar në tregun e lirë dhe konkurrencën lojale.

Marrë në tërësi, po të revidoheshin apo të mënjanoheshin disa dispozita juridike, që përmbajnë të meta juridike dhe të përmirësoheshin gabimet tjera gjuhësore, Ligji do të plotësonte kushtet e një ligji të mirë.

Konkretisht, ligji përmban të meta juridike që manifestohen në nenin 2 të Përkufizimit; në nenin 3 të Rregullat e përmbartimit; në nenin 6 që ka të bëjë me ankesat dhe vendimet përfundimtare; në nenin 7 që rregullon çështjen e bazave për fillimin e procedurës së falimentimit; në nenet 8, 9 dhe 10 që kanë të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe njoftimin e regjistrimeve; në nenin 11, pika c) dhe nenin 12 që kanë të bëjnë me kundërshtimin e kërkesës; në nenin 13 që ka të bëjë me sanksionet dhe pasojat e kërkesës së palejuar; në nenet 17 dhe 20 që rregullojnë emërimin dhe kompetencat e administratorit; në nenet 22, 24 dhe 26 që i referohen kundërshtimit, ankesave dhe kërkesave me dhunë; në nenin 27 alinea 1, pika b) dhe c) që i referohen pasurisë së falimentimit; në nenin 33 që ka të bëjë me moratoriumin dhe ndërprerjen e të gjitha veprimeve; nenin 39 që rregullon tretmanin e kontratave të papërmbyshura; nenin 40, alinea 1 dhe 2 lidhur me sigurimin e shërbimeve profesionale ose personale; nenin 42, alinea 3 dhe 4 që kanë të bëjnë me regjistrimin e kërkesës; nenin 44 lidhur me kamatat dhe moratoriumin; nenin 51 dhe 52 lidhur me planin dhe metodat e riorganizimit; nenin 60 që rregullon shitjen e pasurisë; nenin 76 dhe 77 lidhur me betimin, dëshminë e rreme dhe fshehjen kriminale të pasurisë dhe në fund, nenin 81 që rregullon çështjen e zbatimit ndaj rasteve të pazgjidhura.

Të gjitha vërejtjet dhe sygjerimet konkrete lidhur me këtë ligj do t'ua prezentoj me shkrim komisioneve kompetente në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Naim Maloku, deputet i AAK.

NAIM MALOKU:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Më lejoni ta përgëzoj Kryeministrinë për sjelljen e këtij Projektligji në shqyrtimin e parë në Parlamentin e Kosovës dhe t'i them edhe disa fjalë lidhur me këtë Projektligj.

Unë mendoj se ky Projektligj duhet t'i përfshijë të gjitha subjektet afariste dhe subjektet afariste private. Ne nuk dijmë për momentin sa është i ashtuquajtur i borxhi i brendshëm në Kosovë e që është shumë i rëndësishëm dhe tregon shumë për mundësinë e zhvillimit ekonomik të një shteti. E kam fjalën për borxhet në mes subjekteve afariste dhe konsideroj se ky ligj do ta rregullojë edhe atë çështje në mënyrë që borxhi i brendshëm të zvogëlohet dhe të mos ndodhë që disa subjekte afariste, jo të sinqerta, për shembull të shkatërrojë një subjekt afarist tjetër i cili në mungesë të këtyre borxheve kishte me ndikuar shumë në zhvillimin dhe kishte me ecë përpara.

Unë, sjelljen e këtij Projektligji dhe aprovimin e tij, e shoh edhe nga një kënd tjetër. Ky ligj do të ndikojë edhe në zbutjen e kriminalitetit në Kosovë. Pse po e them këtë? Në shoqërinë kosovare veç është duke u krijuar një shkallë e kriminalitetit të organizuar, pra grupe të cilat bëjnë nxjerrjen me dhunë të borxheve për llogari të firmave të ndryshme, pra që kërkojnë borxhe dhe ato grupe marrin përqindje të caktuara. Pra, është një shkallë e kriminalitetit të organizuar në Kosovë dhe aprovimi sa më shpejtë i këtij ligji dhe zbatimi i tij në praktikë do të ndikonte në uljen e kësaj forme të aktivitetit kriminal në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka deputeti Haki Shatri. Le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligjin për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim të cilin sot po e shqyrtojmë në parim është, do të thojë, një ndër dokumentet shumë të rëndësishme për funksionimin me sukses të mekanizmave të ekonomisë së tregut.

Aprovimi i këtij ligji krijon kushte për kreditimin e ndërmarrjeve private, kushte të domosdoshme, të cilat janë edhe kushte të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe si të tillë propozoj që ne sot në parim ta aprovojmë, kurse vërejtjet të cilat eventualisht ne i kemi, dhe normalisht një pjesë e tyre u prezentua nga parafolësit, ne në procedurë, pas aprovimit në parim, do t'i inkorporojmë dhe besoj do ta nxjerrim një dokument të shkëlqyeshëm i cili do t'i shërbejë ekonomisë së tregut.

Kam një dilemë, Projektligji, zoti kryeministër, thuhet se është për ndërmarrjet private? Unë e di se ky Projektligj, me kohë, me privatizim, do t'i përfshijë edhe ndërmarrjet shoqërore që do të privatizohen dhe pjesa që do të privatizohet, sigurisht do të jetë objekt dhe lëndë e këtij ligji në rast nevojë. Por ndoshta do të ishte dashur diku të thuhet që edhe ndërmarrjet që privatizohen, ndërmarrjet shoqërore, do duhej në një formë të Përmendën por atë, nëse e shohim të arsyeshme, do ta bëjmë në procedurë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Ramadan Kelmendi. Le të bëhet gati deputeti Dragisha Kërstoviq.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, ministra dhe Kryeministër.

Unë, pasi lexova Projektligjin për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim, do të paraqes disa sygjerime t'mia, por në përfundim do ta paraqes edhe amendamentin, natyrisht në emër të grupit të LDK, nëse miratohen.

Mendoj se vetë emërtimi i Ligjit nuk ka të bëjë me përmbajtjen e tekstit, ngase "likuidimi i personave juridikë" nuk mund të bëhet, por fjala është për "shurjen e personave juridikë". Pra, këtu është fjala, të merret veprimi i shuarjes apo i sanimit në fazën e bankrotimit apo të falimentimit ngase "likuidim" do të thotë "zhdukje fizike", pra Ligji duhet të emertohet "mbi shuarjen dhe sanimin" e tjera. Mendoj se Zyra juridike, në veçanti, tani e tutje, duhet të mënjanojë të metat formale juridike në propozimligjet dhe kryesisht pastaj për to të debatohet dhe para se gjithash grupet e ekspertëve lidhur me ligje të tilla siç është rëndësia e tij duhet ta thonë edhe ata fjalën e vet.

Arsyet për ta nxjerrë këtë ligj janë të shumta dhe ato i përkrahu sikur që përkrahu edhe këtë Projektligj. Por, në veçanti është me rëndësi të dihet baza juridike për fillimin e procedurës për shuarjen apo sanimin e personave juridikë në bankrotim, duke përcaktuar subjektin, procedurën lidhur me problematikën e shuarjes së personave juridikë.

Në përmbajtje të Ligjit del se nuk u siguria trajtimi i barabart, pra nuk u sigurohet trajtim i barabart të gjitha palëve që janë të interesuara apo të lidhura me shuarjen në bankrotim, si dhe nuk mbrohen sa duhet dhe si duhet juridikisht të gjitha të drejtat kreditore në rast të shuarjes apo të bankrotimit.

Mendoj se për një çështje juridike, duke aplikuar ligjin, nuk ka nevojë të lëhet mundësia apo rregulla se mund të aplikohen gjegjësisht zbatohen edhe ligjet tjera dhe në këtë rast gjatë shuarjes nuk ka nevojë aq më tepër kur aludohet se mund të aplikohen ligje të një shteti që nuk ekziston dhe të gjitha këto dispozita përfundimtare sjellin probleme.

Pasi Ligji është hartuar në gjuhën shqipe, serbisht dhe anglisht, duhet të përcaktohet se, në rast të interpretimit apo të konflikteve të interpretimit, bazë për sqarimin e tij duhet të jetë teksti shqip.

Në kundërshtim të plotë janë dispozitat njëra mbi tjetrën dhe atë të neni 3 dhe 85 – Rregullat zbatuese dhe Hyrja në fuqi të këtij ligji pas 90 ditësh e tjera.

Baza e shuarjes së borxhit, në lartësinë bazë për shuarjen e një bankrotimi është 2000 euro, dhe është bazë shumë e ulët për fillimin e kërkesës për bankrotim, neni 7, pika 4 b). Mendoj se 2000 euro është nivel i ulët i mjeteve financiare për ta kërkuar shuarjen e një subjekti.

Ligji duhet të përcaktojë format, përmbajtjen dhe kërkesën për bankrotim, e cila duhet të jetë unike dhe duhet të jetë e përcaktuar me ligj.

Sanksionet për bankrotim, kërkesë e drejtë ndaj kreditorit duhet të jetë në rastet e mashtrimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera të sanksionuara dhe për të duhet të jenë përcaktuar me ligj.

Ky ligj nuk siguron mbrojtjen adekuate të mjaftueshme të pasurisë së hipotekës së regjistruar në pasurinë e paluajtshme që është objekt i shqyrtimit.

Megjithkëto sygjerime, mendoj se Ligjin duhet përkrahur parimisht dhe ta plotësojmë me amendamente. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Kërstoviq.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, gospodine Redžepi, gospodo ministri, dame i gospodo poslanici,

Ja ću, naravno, podržati Zakon koji je u ekspozeu obrazložio predsednik Vlade i naravno da svako društvo, u principu, treba da ima takav zakon i da jedan takav zakon mora da reguliše određene odnose u određenoj zajednici.

Ja sam se međjutim javio zbog jedne druge stvari. Zapravo, mislim da su neki poslanici već ušli u neku detaljnu raspravu u zakonu što bi trebalo izbeći i ostaviti vreme da se to čini u onom delu zasedanja Skupštine koji se zove drugo čitanje po Poslovniku i po Ustavnom okviru i mislim da danas ne bi trebalo time da se bavimo.

I naročito sam se javio zbog jedne primedbe koju želim da uputim na ekspozeu gospodina Redžepija. Gospodin Redžepi je u nekoliko navrata u ekspozeu pomenuo atribut zemlje, ove zemlje, privreda zemlje, narod ove zemlje i tako dalje. Mi smo se vratili u ovu Skupštinu sa jednom vrlo teškom odlukom i imamo čvrstu nameru da u ovoj Skupštini ostanemo što duže. Ali, isto tako, molimo za jednu tolerantnu atmosferu i za jedan primeren govor, bar dok ova Skupština bude mogla da radi u ovom sastavu, a nadam se da će to biti malo duže.

U principu, dakle, mislim da je u načelu Zakon prihvatljiv i naravno mi ćemo kao koalicija, u Koaliciji dati doprinos da damo što više i što kvalitetnijih amandmana na ovaj zakon a nadam se da će to da učine i skupštinske komisije i da ćemo već na drugom čitanju imati jednu ozbiljniju raspravu o zakonu i jedan pun doprinos da zakon zaista bude dobar i da bude onakav kakav odgovara kosovskom društvu. Hvala lepo!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Pas diskutimeve të bëra, është koha që të deklarohe mi për aprovim në parim të këtij ligji.

Kush është për? Mesa duket, shumica është për. Ju falemnderit.

A ka ndonjë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenon. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për farërat.**

Materiali iu është dorëzuar deputetëve më 10 janar.

Lus ministrin përkatës, Goran Bogdanoviq, ta arsyetojë ligjin. E keni fjalën zoti Bogdanoviq.

GORAN BOGDANOVIĆ:

Poštovani predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Ministarstvo poljoprivrede i šumarstva i ruralnog razvoja pripremila je u saradnji sa medjunarodnim zajednicama i sa stručnjacima iz ovih oblasti Zakon o semenu. Javne konsultacije su odigrale minimalnu ulogu u pripremi ovog zakona jer Zakon se više bavi tehničkim pitanjima i ima faktički regulatornu funkciju u ovoj oblasti.

Potrebe za ovim donošenjem Zakona su bile svakako velike, zasnovane na činjenici da stari zakon donešen još 1973. godine, koji je važio sve do ovih dana a imajući u obzir novonastalu situaciju na ovim prostorima, nastale promene standarda u kvalitetu semena i potrebe njihovog usaglašavanja sa novim medjunarodnim standardima učinili su da ovaj zakon prevazidjen i nesprovodljiv u ovim uslovima.

Donošenje novog zakona takodje je neophodan za zaštitu novih selekcionara i varieteta proizvedenih na ovim prostorima ili uvezenih iz inostranstva na ove prostore, te uvođenjem ovih kvaliteta sa višim potencijalom u cilju sprečavanja prinosa i povećanja prihoda.

Ja ću vam ukratko ovde reći šta sadrži, znači, Zakon o semenu i ovde ima četiri poglavlja: ... lista i prava selekcionara biljaka, proizvodnja i certifikaciju i plasman semena, zatim kontrolu uvezenog semena i naravno – kaznene odredbe.

... lista ili semenska lista podrazumeva listu biljnih kvaliteta koji imaju pravo da se uzgoje i plasiraju na ovom području. Utvrđivanje liste ima za cilj promociju novih varieteta sa većim genetskim potencijalom u poredjenju sa onima koji se sada koriste ili koji se plasiraju na ovo područje.

Prvo poglavlje znači ovog zakona određuje proceduru primene kriterijuma za unošenje jednog varieteta u listu, tojest registar ili spisak, testiranje uzgojne i upotrebne vrednosti, funkcije, znači kancelarije prava varieteta i naravno žalbenu proceduru na taj postupak. Nadležni organ za stvaranje ... liste jeste kancelarija za prava varieteta, odseka za proizvodnju i zaštitu bilja Ministarstva poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja i naravno na osnovu predloga gde će se osnovati komitet koji će biti sastavljen od svih relevantnih faktora ili stručnjaka koji budu zastupljeni iz te oblasti. Komitet koji će voditi ovu listu jeste stručno telo, znači iz područja naravno semena, iz područja znači poljoprivrede koji će savetovati Ministarstvo na tehničko-stručnom planu u čijem sastavu će naravno da bude uključeno i Ministarstvo, uključen i Poljoprivredni fakultet ovde u Prištini, Poljoprivredni fakultet na severu Kosova, zatim druge institucije ili instituti koji su zainteresovani za ovu oblast a naravno i predstavnici trgovaca, predstavnik udruženja proizvođača semena i predstavnik naravno farmera.

Drugo poglavlje, koje je isto karakteristično i vrlo bitno je proizvodnja, sertifikacija i plasman semena. Ovo poglavlje sadrži pravila i procedure proizvodnje, umnožavanje, plasman, prerade, pakovanje, označavanje, etiketiranje i možemo slobodno reći koje će imati jedno certifikacionu šemu semena. Takođe utvrđuje autoritet i način laboratorijskog testiranja i poljskih inspekcija u cilju utvrđivanja kvaliteta semena i varieteta čistoće biljaka.

Jedini autoritet za sertifikaciju semena naravno biće odeljenje koje će pri Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja biti formirano u saradnji sa fitosanitarnom i semenskom inspekcijom i institutom koje ga ovlasti Ministarstvo poljoprivrede i radiće znači na sertifikaciji takvih proizvoda.

Ovde isto u ovom zakonu je dato uvoz-izvoz semena. Mogu vam reći da je to dosta obuhvaćeno ili uvučeno u ovlašćenje koje zadržava UNMIK, ali mi ćemo svakako u saradnji sa UNMIK-om imati u vidu takvu činjenicu i saradjiivaćemo u toj oblasti ali ovaj deo zakona određuje uslove i standarde koje treba da ispuni jedna pošiljka semena koja se uvozi ili koja se izvozi sa ovih terena.

Obavezni uslovi su da jedan varietet koji je uvezen bude na listi, da bude certifikovan i da ispunjava standarde OECD-ea i da bude testiran po standardima ista i da ima fitosanitarni certifikat, naravno. Ovo ima za cilj da spreči unošenje semena sumnjivog kvaliteta, zaštitu selekcionara, proizvođača i registrovanje trgovaca i na kraju povećanje proizvodnje koji je naravno i glavni cilj ovog zakona.

Izvoz semena takođe treba da ispuni iste standarde i nadležni organ za ceretifikaciju semena za izvoz jeste odeljenje koje će biti formirano ili odsek za proizvodnju i zaštitu bilja pri Ministarstvu poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja.

Naravno, kao svaki zakon, i ovaj zakon ima kaznene odredbe koji ima za cilj prevashodno da zaštiti i u sprovođenju istog radi proizvodnje što kvalitetnijeg semena koje će se ovde distribuirati.

Na kraju rećiću vam da u izradi ovog zakona smo imali veliku podršku, znaći medjunarodnih zvanićnika prevashodno od EAER-a preko konsultanata NIB-a iz Engleske i naravno nařih strućnjaka koji rade u Ministarstvu poljoprivrede.

Mogu vam reći isto da smo održali par seminara na ovu temu, znaći iz oblasti semenarstva i da smo imali određenih sugestija koje smo uvrstili u ovaj zakon i mislim da je ovaj zakon vrlo dobar i da bi ga trebalo prihvatiti. Hvala!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti ministër ju falemnderit.

Hapim debatin në parim.

Do t'ju lutem: detajet t'i leni kur të kemi shqyrtimin e dytë, do të thotë, ata deputetë që janë të përgatitur të paraqiten. Fjalën e ka Tomë Hajdaraj.

TOMË HAJDARAJ:

Ju falemnderit zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë, përfaqësues të Qeverisë së Kosovës,

Kur është fjala për Ligjin mbi farërat, për këtë projekt konkret që kemi, zoti kryetar, nuk mund t'i ikim çështjes dhe ndoshta do të ndalemi edhe në thelbësoren që në start, sepse unë mendoj se hartuesit a mos janë ngutur apo kanë përfshirë edhe një lëmi tjetër ku është fjala për prodhimin e fidaneve, do të thotë, për fidanet e pemëve, fidanet e pyjeve dhe të hardhisë së rrushit. Andaj, unë propozoj që kjo çështje të rregullohet me ligj të veçantë.

Ndërsa, sa i përket fushëveprimtarisë së Ligjit, me të vërtetë ka rëndësi miratimi i një ligji të tillë, do të thotë për herë të parë në Kosovë, sepse e dijmë mirëfilli se rreth 326 mijë, do të thotë edhe më shumë sipërfaqe, të cilat mbjellen me kultura të ndryshme në Kosovë, deri më tash janë mbjellur me farëra të paseleksionuara, me farëra të ofruara a dhe të pavërtetuara shkencërisht. Andaj, nga kjo rrjedh fakti se me dhe në përbërje të këtij ligji të parashohim rrugën e përpilimit të rregullativave dhe standardeve evropiane dhe më gjerë. Kur them më gjerë, kam parasysh edhe shtetet tjera jashtë Bashkësisë Evropiane sepse ne duhet të jemi lojalë dhe konkurrentë të lirë në treg. Mirëpo, ku e them këtë, kam parasysh edhe verifikimin paraprak në mënyrë shkencore të varieteteve të cilat janë kompatible për kushtet e Kosovës.

Ndërsa, sa i përket pjesës së tërësishme të Ligjit, e tha edhe përfaqësuesi i Qeverisë, është ligj praktik, është i standardizuar dhe në krahasim me ligjin që kemi marrë të pyjeve, ky është ligj më i mirëradhitur, më i mirëpërfshirë, edhe pse ne si Komision dhe mendoj edhe ekspertë të cilët do t'i angazhojmë në punën tonë të mëtutjeshme, do t'i japin vlerësimet e veta, duke u nisur nga Fakulteti i Bujqësisë, si më i thirrur,

Akademisë së Shkencave e të Arteve dhe njerëzit që merren me këtë prodhimtari, e që mendoj se me këtë ligj krahas përfitimit në kualitet për njësi të sipërfaqës dhe në sasi, ne do të kemi edhe vijat të cilat mendojmë se duhet sa më parë t'i përfitojmë në Kosovë dhe të mos importohen qind për qind, sepse deri më tash, e dijmë mirëfilli, nuk kemi asnjë vijë e cila përfitohet në Kosovë. Andaj, mendoj se Ligji meriton një mbështetje dhe duhet ta mbështesim, në mënyrë që në këtë sezonë të mbjellave pranverore, mos asgjë tjetër, t'iu ndalim trendin matrapazëve të cilët nuk kanë lidhje me import gjegjësisht me farën, për farën dhe rëndësinë që ka fara për të mbjellurat e Kosovës, e që thotë populli – atë që mbjell edhe e korrë. Andaj, ne dëshirojmë që të korrim sa më shumë, sa më të shëndetshëm dhe në sasi të mjaftueshme për popullin e Kosovës. Prandaj, ftoj deputetët që ta mbështesin këtë projektligj. Ju falemnderit!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Sebahate Grajçevci. Le të bëhet gati Ibush Jonuzi.

SEBAHATE GRAJÇEVCI:

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë,

Projektligji mbi farërat, marrë në tërësi, është punuar me profesionalizëm dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare për prodhimin dhe tregtimin me farë, është hartuar me një gjuhë mjaft të qartë, prandaj shfrytëzoj rastin ta përgëzoj Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në veçanti ministrin e posaçërisht do t'i përshëndesja hartuesit e këtij projektligji.

Nevoja për këtë ligj është ndie mjaft, sidomos kur kemi parasysh situatën e përgjithshme në bujqësi viteve të fundit, kur Kosova është tregu më liberal në rajon, ndoshta edhe në botë dhe falë kësaj, kompanitë shpesh të përegjistruara e të palicencuara në kohët e të mbjellurave sjellin farë apo patate për farë në cilësi të dobët dhe i shesin në parkingun e kamionëve pa dokumente përkatëse. Këto, në rastet më të shpeshta, janë mundësuar nga Serbia. Kjo s'do koment, sepse ne dijmë çfarë ishin rendimentet e kulturave lavërtare apo atyre bujqësore në tërësi.

Unë gëzohem që tani ky ligj, prodhuesit tanë bujqësorë do t'i mbrojë sa i përket kualitetit të farës, por ajo që mua më shqetëson - është se prodhuesi ynë prapë do të jetë i ballafaquar me një konkurrencë jolojale dhe interesi i tij ekonomik nuk është i mbrojtur.

Thënë shkurt, ky ligj duhet të përfshijë edhe politikën fiskale, ashtu që importuesit e farës, lëndës së parë apo repromaterialit, si të doni i themi, duhet të lirohen nga aktciza apo së paku këto aktciza dhe dogana të jenë të një norme më të ulët. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Ibush Jonuzi, le të përgatitet Berat Luzha.

IBUSH JONUZI:

Zoti kryetar, kryesi e punës, deputetë të nderuar,

Projektligji për të cilin po diskutojmë sot, si ai më herët edhe tani, janë të një rëndësie të veçantë.

Do të ndalem konkretisht për farën e patateve. Për të pasur prodhimë cilësore dhe rendimente të larta të prodhimeve sigurisht, u tha edhe më herët, duhet të jetë fara e cilësisë së lartë kur dihet që prej të gjitha prodhimeve bujqësore që kultivohen patatja kërkon sasinë më të madhe të farës, më mirë me thënë, për një hektar të patatës në kultivim nevojitetn 2 mijë kilogramë farë të patatës. U tha në diskutimin e mëhershëm se duhet të kemi kujdes në këtë drejtim dhe po e citoj se – kryesisht furnizimi respektivisht importimi i farës bëhet nga Holanda dhe prej viseve tjera, por me theks të veçantë nga Holanda, duke pasur parasysh se vushtriasit janë kultivues numër një të patateve, këto të dhëna i kam nga ekspertë të cilët bëjnë kultivimin e patatës, por do të ndalem pakashumë në pika të shkurtëra të një analize që është bërë në terrenin e Shalës për kultivim të farës tek ne prej Agjencisë Evropiane, ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë se ka kushte ideale për prodhim të farës, do të thotë, në regjionin tonë të Shalës por edhe në viset tjera të Kosovës, për çka prodhuesit tanë dhe bujqit tanë për këtë çështje kanë nevojë dhe u duhet mbështetje e madhe në mënyrë që të mos presim ardhjen e farës prej vendeve tjera por të bëhemi ne prodhues së farës tonë. Dihet se vetëm për komunën e Vushtrisë, diku nevojiten rreth 2400-3000 ton farë, sepse kultivohen 1200 deri 1500 hektarë në vit sepse Vushtria është prodhuesi kryesor. Andaj, mund të them edhe këtë se të gjitha prodhimet bujqësore importohen e për momentin vetëm patatja nuk importohet sepse ka sasira të mjaftueshme të prodhimeve tona.

Dhe, krejt për fund, sepse mendoj që ky Parlament meriton të jetë i informuar se programi për përpunim të patateve, respektivisht projekti është rrumbullaksuar në komunën e Vushtrisë dhe pritet në çdo moment të startojë, që do të thotë se patatja nuk do të dalë në treg vetëm si prodhim por edhe si përpunim final. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Berat Luzha.

BERAT LUZHA:

Të nderuar deputetë, i bashkëngjitem përgëzimeve për Ministrinë e Bujqësisë, e cila na ka sjell një ligj të mirë, një ligj i cili është i përgatitur me përkushtim, i cili ka një gjuhë

të rrjedhshme, është i kuptueshëm, i qartë dhe para se gjithash është një ligj, mund të them i pari që na ka sjell Qeveria i lektuar. Do të thotë deri tash asnjëherë nuk kemi pasë ligje të lektuara dhe kanë ardhur ato me gabime të shumta edhe drejtshkrimore, edhe logjike dhe të tjera. Vërejtja është se në nenin 3, ekzistojnë 39 pika, që është tepër shumë dhe disa nënpika, e që mendoj se duhet të thjeshtësohet kjo dhe ajo ka të bëjë me definicionet e termave që është një lloj fjalorthi në miniaturë. Ky nen ose duhet të dalë në preambulë, të thjeshtësohet dhe të hiqen disa terma të cilat janë të njohura për të gjithë, siç është, ta zëmë termi “ministri” dhe shpjegohet se çka është ministri, kurse të gjithë ne dijmë se çka është ai. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Pas të gjithë diskutantëve që janë paraqitur për shqyrtim të parë, është koha për t’u deklaruar.

Kush është për aprovim, në parim, të këtij projektligji? Ju falemnderit!

A ka kush kundër? Asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Asnjë abstenim. Ju falemnderit.

VOTIMI – GLASANJE – VOTED:	
Për - Za – For: -----	Të gjithë – Svi - All
Kundër – Protiv – Against -----	0 0
Abstenuan – Uzdržanih – Abstained: -----	0 0

Tani do të kemi një pauzë prej 30 minutash dhe pastaj do ta vazhdojmë punën me shqyrtimin e dytë të Projektligjit.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës seanca vazhdoi punën)

NË VAZHDIM, PUNËN E SEANCËS E KRYESOI HYDAJET HYSENI:

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Deputetë të nderuar, vazhdojmë seancën me rendin e aprovuar të ditës. Në radhë është tani **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pyjet e Kosovës.**

Lus shërbimin që të konstatojë gjendjen e kuorumit. Siç duket kemi kuorum të nevojshëm dhe mund të vazhdojmë me punën.

Besoj se materialet lidhur me Projektligjin i keni marrë me kohë i cili ka qenë shqyrtuar dhe aprovuar në shqyrtimin e parë. Edhe amendamentet e propozuara janë shpërndarë, ndoshta jo me kohë por megjithatë në afat të durueshëm, të cilët besoj i keni para veti në tavolinë. Prandaj, nëse pajtoheni dhe nëse s'keni vërejtje, të fillojmë me shqyrtimin e dytë të Projektligjit dhe ndërkohë shërbimi le të jetë i gatshëm që të shkojë puna si duhet. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha. Urdhëroni zoti Luzha.

BERAT LUZHA:

Para se të fillojë miratimi i Ligjit nen pas neni, mendova t'i them disa fjalë apo vërejtje që kam në përgatitjen e Projektligjit nga Komisioni, i cili ka bërë një punë vërtetë shumë të madhe dhe është munduar ta bëjë një ligj të mirë, megjithatë mendoj se Ligji nuk ka mund të bëhet ai që do të duhej të ishte për shkak të mangësive të mëdha, për shkak se ligji ka qenë tepër i dobët dhe për shkak se është në shumtën e rasteve i paqart dhe me kuptimsi të ndryshme. Aq më tepër, mendoj se një nga të metat kryesore është se komunat nuk kanë asnjë ingjerençë në menaxhimin, gjegjësisht në qeverisjen e pyjeve edhe pse në kuadër të çdo komune është formuluar se do të ekzistojnë zyrat apo njësitë e agjencionit të pyjeve të Kosovës. Mendoj se njësitë e APK do të duhej të kishin dy shtrirje: shtrirjen horizontale, që do të ishin të lidhura me qeveritë komunale dhe shtrirjen vertikale që do të ishte lidhja me APK-ën apo me ministrinë përkatëse. Mosfunktionimi i kësaj lidhjeje me siguri se ka me pasur pasoja në zbatimin e Ligjit dhe ka me pasur reagime nga komunat, të cilat, një pjesë e tyre e madhe, kanë pasuritë me të cilat kanë disponuar deri më tash.

Me këtë Projektligj edhe pse është biseduar shumë, nuk ka dalë statusi përfundimtar i ekonomive pyjore, të cilat deri tash e kanë bartë barrën e ndërmarrjeve të cilat kanë menaxhuar me pyje.

Unë mendoj se ekonomitë pyjore nuk kanë qenë as në sistemin socialist të kaluarin thjeshtë ndërmarrje shoqërore, për shkak se ato i kanë pasur rojet e pyllit, kanë pasur inspektorët, kanë dhënë leje, kanë shënuar drunjt, kanë bërë planifikimin, menaxhimin

e tjera, të cilat nuk do të kishin mund t'i bëjnë një organizatë apo një ndërmarrje shoqërore. Dhe, si e tillë, ekonomitë pyjore, mbesin jashtë këtij ligji dhe statusi i tyre mbetet shumë i paqart, ato mbesin në mëshirën e kohës dhe mbesin pa status fare.

Tjetra, e vetmja që përfitojnë komunitet, është një 20-përqindësh që mendohet t'iu ndahet nga shitja e trungjeve, që mendoj se është shumë pak, për shkak se me një 20-përqindësh është një lëmoshë e thjeshtë dhe komunitet nuk do t'ishin me siguri të kënaqura me një gjë të tillë dhe ndoshta më mirë do t'ishin fare të mos i ndahej as ai 20-përqindësh. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin, por më lejoni ta bëj një vërejtje që në fillim. Unë kisha përshtypje se vërejtjet do të kenë të bëjnë me çështje procedurale. Tani jemi në shqyrtimin e dytë të Projektligjit dhe vërejtjet e kësaj natyre që dëgjuam kanë vendin në shqyrtimin e parë, në parim, të projektligjeve. Prandaj, procedojmë sipas procedurës së përshkruar në Rregullore. Sipas Rregullores, qëndrimet e tyre në parim mund t'i paraqesin sponsoruesi i ligjit, nëse është i interesuar, nëse është i pranishëm këtu, mund ta marrë fjalën dhe pas tij do t'u jipet fjala komisioneve, së pari Komisionit funksional, pastaj Komisionit për buxhet dhe Komisionit për komunitete. Natyrisht, nëse ato konsiderojnë se duhet t'i drejtohen Kuvendit. Urdhëroni, nuk është e paraparë, nëse është e nevojshme, ne vendosim.

GORAN BOGDANOVIĆ:

Poštovano predsedništvo, poštovani narodni poslanici,

Ja ću samo jednu primedbu oko opština. Vi svi znate da je gospodin Štajner obećao decentralizaciju Kosova. Prema tome, znači i opštine će biti, sigurno imati svog udela u tome i naravno šumarstvo. Svi vi znate da i u ranijem zakonu, znači zakon koji je zadnji na snazi ovde, znači zakon od 1987. godine je da opštine faktički nisu imale nikakvo svojstvo, to jest nisu bili vlasnici šuma niti zemljišta šumskog. Mi smo ovde izašli u susret nekim sugestijama i dali smo za pravo da opštine dobijaju i 20% od ukupnog prihoda, mada u ranijim zakonima(tonski prekid)...da šumska agencija će imati svoje jedinice u svim opštinama, tako da i to je jedan od vrlo bitnih ustupaka u ovom zakonu. Toliko za sada.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë ministrin për sqarimet e tij. E ka fjalën përfaqësuesi i Komisionit funksional, do të thotë Komisionit për bujqësi dhe çështjet e pyjeve.

TOMË HAJDARAJ:

Të falemnderit, zoti kryesues. Para se të jap një raport të shkurtër për punën që ka bërë Komisioni, më duhet që tri çështje këtu t'i parashtoj lidhur me shqetësimin e zotit Luzha, te kompetencat e komunave ndaj pyjeve, te ndërmarrjet, domethënë, te fati i ndërmarrjeve pyjore komunale dhe te 20-përqindëshi i mjeteve, do të thotë, të cilat ndahen nga të ardhurat nga pylltaria.

Sa i përket raportit, do të thotë të marrëdhënies, gjegjësisht shtrirjes së niveleve, ne kemi bërë të pamunduren si Komision sepse për këtë punë jemi ulur rreth 5 muaj dhe duke pasur parasysh se pyjet janë resurs kombëtar i një vendi dhe duke pasur parasysh se me pyjet publike për momentin menaxhon Përfaqësuesi Special i SP, duke pasur parasysh diskutimet që kemi pasur me këshilltarët ndërkombëtarë dhe duke u nisur nga hartuesi i këtij projekti, zoti Ollson, zoti Gejnar dhe përfaqësues tjerë të USAID-isë, kemi ardhur në përfundim dhe kemi qenë të gjithë një, jo vetëm Komisioni ynë por edhe ai për komunitete dhe ai për buxhet, e mendoj edhe ai për legjislacion nuk ka kundërshtuar apo dhënë ndonjë vërejtje në këtë aspekt, kemi bërë këto amendamente të cilat mendojmë se për momentin janë të qëndrueshme. Por, neni 39 atje decidivisht thotë, me vetë faktin se shkon ose pushon aktiviteti i administratës ndërkombëtare, atëherë çështjet do të rregullohen.

Përsa i përket asaj që janë të lëna anash komunat, unë mendoj se nuk qëndron fakti aq ashpër, sepse vetë fakti që njësitë komunale të Agjencionit Pyjor të Kosovës dihet çfarë roli kanë. Ne kemi deciduar atje çfarë roli ka. Dihet, planet menaxhuese afatgjata për pyjet kush i bën. I bën Ministria, i bën në rastin konkret Agjencioni i Kosovës për Pyjet, ndërsa planet operationale i bën njësia në bashkëpunim me kuvendin komunal gjegjësisht organin kompetent dhe ajo është drejtoria komunale për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural. Ndërsa, sa i përket ndërmarrjeve pyjore komunale për fatin e tyre, ne kemi pasur disa takime nivelesh të ndryshme dhe e dijmë mirëfilli se të gjitha organizatat e sektorit të ashtuquajtur shoqëror tash janë pjesë e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit. Por, në ligj shkruan që po qe se ato organizata privatizohen si të specializuara, për raste eventuale ato me tender, si të specializuara, mund të fitojnë punët e tyre rreth mirëmbajtjes... në tërësi.

Ndërsa, sa ai përket 20-përqindëshit, unë së bashku me të gjithë kolegët, edhe me zotën Luzha dhe të tjerët, në Komision dhe në Komisionin për buxhet dhe Komisionin për komunitete, kemi arritur ta fitojmë plafonin e mundshëm i cili është i caktuar me konventat ndërkombëtare për të ardhurat nga drunjt në këmbë dhe pjesa tjetër në nivele komunale. Mendoj se ky nuk është thjeshtë një buxhet formal, por është një buxhet i cili për komunat të cilat kemi thënë se kanë resurse pyjore ka një domethënie të jashtëzakonshme dhe për ato komuna të cilat marrin këtë 20-përqindësh nuk do të thotë se do të ndikojë negativisht edhe participimi i tyre në buxhetin komunal nga ministria e financave, do të thotë nga fondi i konsoliduar apo nga Buxheti i Kosovës.

Më lejoni që para jush sot, të paraqesim një raport të shkurtër lidhur me punën që kemi bërë si Komision parlamentar për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural gjatë hartimit të amendamenteve gjegjësisht vërejtjeve në Projektligjin mbi pyjet e Kosovës, të hartuar nga Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Kosovës.

Që në fillim, Komisioni ynë ka patur projektin apo versionin e punës të këtij projekti, domethënë para se të hyjë në procedurën e leximit të parë dhe atë duke shfrytëzuar marrëdhëniet e mira që kemi me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, gjegjësisht duke patur parasysh rëndësinë paraprake të këtij ligji i cili do të vinte në Parlament.

Si Komision kemi mbajtur disa takime rangjesh të ndryshme, të cilat do t'i ceku sot. Thash, nga versioni i punës, do të thotë ka marrë pjesë drejtori i autoritetit të atëhershëm e tash Agjencion Qendror Pyjor të Kosovës së bashku me stafin e tij dhe gjithashtu në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i Sindikatave të Pavarura të Pylltarisë së Kosovës. Dhe, pas këtij takimi kemi parë të arsyshme që si Komision të organizojmë edhe takime të radhës dhe gjithashtu në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, posaçërisht me stafin juridik, me në krye zotin Xhevat Azemi, për të cilin mendoj se duhet të kemi një rrespekt dhe vlerësim shumë pozitiv në punën e tij profesionale dhe në bashkëpunim me të kemi arritur që ligjin e parë dhe të miratuar në parim, edhe pse me vërejtje të shumta, e kur them me vërejtje të shumta do të thotë që ka qenë diçka e veçantë, sepse ne kemi miratuar në parim edhe ligje të tjera të cilat me të vërtetë kanë patur gabime, por mendoj se ky ligj nuk don koment për vërejtjet që ka paqtur por edhe për atë moment kur kemi vepruar ka qenë e pamundshme që të jetë edhe sot i përkryer.

Prandaj, pas punës që kemi bërë, do të thotë miratimit në parim, kemi marrë një përgjegjësi dhe dinamikë të shtyrjes përpara të këtij ligji të veçantë për Kosovën. Kur them të veçantë për Kosovën kam parasysh faktin se me këtë ligj do të menaxhohet gati gjysma e sipërfaqës së tokës të Kosovës dhe do të thotë nuk kemi të bëjmë me një ligj formal por kemi të bëjmë me një ligj i cili është me të vërtetë ligj bazik për këtë degë të ekonomisë dhe pasurisë kombëtare të Kosovës. Andaj, së bashku, prapë po e them, me Ministrinë kemi pasur kontaktet të herëpashershme por vlenë për t'u veçuar takimi të cilin Komisioni ka pa të arsyeshëm ta organizojë me ekspertët e lëmisë së bujqësisë dhe të përafërt të pylltarisë nga të gjitha institucionet arsimore, shkencore dhe institucionale ekzekutive dhe legjislative nga lëmi i pylltarisë, ku kemi marrë vërejtjet dhe sygjerimet nga prezentët në atë takim.

Duke patur parasysh që mos anashkalohen edhe hartuesit e projektit në fjalë, ne kemi patur edhe një takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë në shkallë të lartë, pa ministrin, por gjithashtu me prezencë mjaft komplekse dhe domethënëse për ne, me në krye sekretarin permanent të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, zotin Ibra, drejtorin e Autoritetit Pyjor të Kosovës, shefin e shërbimit juridik. Po ashtu kemi pasur në këtë takim prezent edhe këshilltarin e lartë ndërkombëtar zotin Maurico Farinelli dhe përfaqësuesin e hartimit, do të thotë hartuesin zotin Ollson i cili mesa e di unë është edhe hartues dhe bartës i këtij projekti. Nga ky takim kemi nxjerrë prapë risi, sepse ministria gjegjësisht stafi profesionist, me në krye udhëheqësin e shërbimit juridik ka pru disa propozime duke pasur parasysh projektin që kemi edhe ne. Mirëpo, duke pasur parasysh edhe leximin, ndërkohë gjegjësisht kontaktin me problemet të cilat do të na përcjellin gjatë implementimit të këtij ligji, domethënë pas aprovimit, iu jemi mirënjohës kontributeve të tyre të dhënë. Ne jemi munduar që si Komision, para se të hyjmë në leximin nën për nën të kemi edhe një brum shtesë konform projektit i cili ka qenë bazë e punës sonë, sepse ne nuk kemi guxuar t'i largohemi projektit.

Komisioni ka mbajt 9 takime dhe jo formale por me punë intensive. Sa i përket asaj që në sot kemi rumbullaksuar si Komision parlamentar për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, brumi i amendamenteve është konsultuar edhe me përfaqësuesit ndërkombëtarë, si të USAID-isë dhe të tjerë. Nga USAID-i përmendi zotin Riçard Gajner, i cili, sa i përket këtij ligji, ka dhënë një kontribut të veçantë.

Gjithësesi kemi intervenuar aty ku kemi parë të domosdoshme konform specifikave dhe rrjedhave në Kosovë në lëmin e pylltarisë gjegjësisht konform harmonizimit në të gjitha aktet normative të Bashkësisë Evropiane dhe më gjerë nga lëmia e bujqësisë gjegjësisht pylltarisë.

Unë them edhe një fjali e cila është ndoshta paksa specifike për rrjedhat e punës së Komisionit në fjalë. Sepse krahas punës profesionale ne jemi munduar që të bëjmë edhe një punë në lekturimin e Ligjit, duke patur parasysh faktin se në Komisionin tonë, për fat të mirë, kemi edhe lektor të mirë.

Sipas bashkëpunimit që kemi edhe me komisionet tjera, kemi harmonizuar këto amendamente edhe me Komisionin për komunitete, Komisionin për buxhet dhe të njëjtat kanë përkrahur në tërësi grumbullin e amendamenteve të hartuara nga Komisioni parlamentar për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa sa i përket pjesës nën për nën gjegjësisht profesionale dhe atë në kuptimin juridik po them me përkushtim dhe përgjegjësi sepse kontribut të veçantë ka dhënë zoti Idriz Tahiraj, këshilltar i Kryesisë së Parlamentit, i cili është sot prezent këtu.

Dhe, në fund, mendoj se është koha të nisemi me miratimin e amendamenteve një për një dhe të shikojmë problemet ku është intervenuar. Ndoshta dikush mendon ndryshe edhe pse ne kemi vepruar dhe menduar kështu. Por fjalën përfundimtare e ka Kuvendi i Kosovës, dhe ju të nderuar deputetë. Ju falemmderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSANI:

Falënderojmë deputetin Hajdaraj, dhe Komisionin për punën që ka bërë, megjithëse raporti do të mund të ishte më i shkurtër. Besojmë se raportet e komisioneve tjera nuk do të jenë aq të gjata.

Ftoj përfaqësuesin e Komisionit për buxhet. Siç po duket, nuk dëshiron t'i drejtohet Kuvendit. Sipas radhës, ftoj Komisionin për komunitete. Edhe ky Komision ka të njëjtin qëndrim.

Ka kërkuar fjalën Komisioni për çështje legislative. Nëse pajtohem – ta dëgjojmë.

Ndërkohë t'ju informoj se Kuvendi ka kuorum të mjaftueshëm meqë janë të pranishëm rreth 80 deputetë, prandaj mund të vazhdojmë punën.

E ka fjalën Kolë Berisha.

KOLË BERISHA:

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe kornizë kushtetuese, duke u mbështetur në kompetencat që dalin nga Rregulla 31, pika 2 dhe 4 dhe Rregulla 32, pika 1 të Rregullores së përkohshme të punës të Kuvendit të Kosovës, si dhe nga Rregulla 14 e Shtojcës 2 të të njëjtës Rregullore, në mbledhjen e vet të mbajtur, shqyrtoi Projektligjin për pylltari të Kosovës dhe nxori këto

P Ë R F U N D I M E:

1. Lëmia të cilën pretendon ta shtjellojë dhe sanksionojë ky projektligj, pra Ligji për pyjet nëse miratohet, nuk bie në ndesh me kompetencat e rezervuara të PS të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe është në harmoni të plotë me nenin 5.1-j) të Kornizës kushtetuese të Kosovës.

Duke filluar nga vetë titulli ose emërtimi i tij e deri te dispozitat e fundit, ky projektligj lëngon nga paqartësia totale, konfuziteti, mungesa e gjuhës juridike-profesionale, përdorimi i panevojshëm dhe i tepruar i fjalëve dhe shprehjeve të huaja në vend të atyre shqipe, definimet e shtrembëruara të termave të ndryshëm, përkufizime jashtë çdo logjike e subjekteve të përfshira në këtë tekst, shënimi me numra romak i neneve apo rregullave që nuk është praktikë në hartimin e ligjeve që i njohim deri tash e deri te masat drastike për shkelësit e këtyre rregullave.

2. Që të mos ndalem në secilin nen veç e veç, sa për ilustrim po përmendi vetëm dy nenet e para: neni I, natyrisht me numër romak – Seksioni 1.01, thotë – “Ky ligj mund të citohet”, citohet ligji nga ndokush tjetër, për shembull dispozita ligjore, por jo të citohet në kuptimin që thotë këtu “ky ligj mund të quhet”. Thotë – “mund të citohet si ligj mbi pyjet e Kosovës”, ndërsa neni II – Seksioni 2.01, thuhet “siç është përdorur në këtë ligj, përveç nëse nga kontesti kërkohet ndryshe”. Kjo fjali rrjedh si prej qielli. Nuk ka kurrfarë kontesti me tekstin tjetër dhe vazhdon me pikën “a) anëtarë të familjes nënkupton: bashkëshortin, fëmijët, prindërit, gjyshin, gjyshen, vëllezërit, motrat, hallat, dajët, tezet, dajallarët dhe bashkëshortët e tyre”, ka munguar me thënë “edhe krejt Kosovës”, dhe
3. Duke patur parasysh se me këtë tekst ose me tekstet e tilla të projektligjeve ky Kuvend ballafaqohet pothuaj për çdo javë, Komisioni për çështje legjislativë, gjyqësore dhe kornizë kushtetuese, i propozon Kuvendit të Kosovës ta angazhojë një grup ekspertësh për hartimin e ligjeve ose të projektligjeve që dalin në këtë Parlament.

Ju falemnderit!

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin Berisha. Sipas rregullit raportet dhe qëndrimet e komisioneve, ato që janë të përshkruara në Rregullore duhet të dorëzohen me shkrim dhe besoj se në të ardhmen do të kihet parasysh kjo në mënyrë që deputetët të kenë kohë të informohen me kohë me to.

Meqë, siç shihni komisionet kanë kryer punën e vet, atëherë mund të shkojmë në shqyrtimin nën për nën të amendamenteve të parashtruara.

(Diskutohet nga vendi, nuk dëgjohet)

Do të dëshiroja shumë, por druaj që s'na lejon Rregullorja mirëpo mund të vendosim ne. Megjithatë, mendoj meqë komisionet kanë harmonizuar qëndrimet e tyre kjo do ta lejojë procedurën edhe pse nuk jam në dakord me atë procedurën turbo por do të përpiqemi të jemi sa më azhurë.

Amendamenti 1. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

A ka Komisioni funksional ndonjë vërejtje plotësuese?

Komisioni i buxhetit? Në dakord.

Komisioni i komuniteteve? Dakord.

Vë amendamentin në votim.

Kush është për amendamentin 1, i lutem të çojë dorën. Shumica, 65 janë për.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Ka propozime që të thjeshtësojmë procedurën, do të thotë të numërojmë votat vetëm në rastet kur ka dallime të vogla.

A pajtohet Kuvendi me këtë procedurë? Ka vërejtje ndaj këtijpropozimi, prandaj të shkojmë me procedurën e paraparë.

Amendamenti 2. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet e përhershme.

Komisioni funksional, çfarë qëndrimi ka? Është dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë propozimin në votim.

Kush është për amendamentin? Shumica, 64 janë për.

Kush është kundër? Askush.

Kush abstenon nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 3. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet e përhershme.

Komisioni funksional, çfarë qëndrimi ka? Është dakord.

Komisioni për buxhet? Po ashtu.

Komisioni për komunitete. Dakord.

Vë propozimin në votim.

Kush është për amendamentin e propozuar? Shumica, 68 për.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 12 abstenojnë.

Amendamenti 4. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional, çfarë qëndrimi ka. Është dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Për janë 66 deputetë.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 14 abstenojnë.

Amendamenti 5. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet e përhershme.

Komisioni funksional, çfarë mendimi ka? Është dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë propozimin në votim.

Kush është për, i lutem le të çojë dorën. Për janë 67 deputetë.

A ka kush kundër? Kundër nuk ka.

A abstenon ndokush nga votimi? 12 abstenojnë.

Amendamenti 6. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet e përhershme.

Komisioni funksional, çfarë mendimi ka? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë propozimin në votim.

Kush është për këtë propozim? Shumica për.

A është kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 9 abstenojnë.

Amendamenti 7. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional, çfarë qëndrimi ka? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë propozimin në votim.

Kush është për, i lutem le të çojë dorën. Shumica për.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 deputetë abstenojnë.

Amendamenti 8. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional, çfarë qëndrimi ka? Dakord.

Komisioni për buxhet? Po ashtu.

Komisioni për komunitete? Po ashtu.

Vë propozimin në votim.

Kush është për? Shumica për.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 9. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 10. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.
Komisioni për buxhet? Dakord.
Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë propozimin në votim.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 12 abstenojnë.

Amendamenti 11. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional, çfarë qëndrimi ka? Dakord.
Komisioni për buxhet? Dakord.
Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër?
A abstenon ndokush nga votimi? 15 deputetë abstenojnë.

Amendamenti 12. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional, çfarë mendimi ka? Dakord.
Komisioni për buxhet? Po ashtu.
Komisioni për komunitete? Po ashtu.

Vë në votim propozimin?

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 13. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.
Komisioni për buxhet? Dakord.
Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin?

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 14. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.
Komisioni për buxhet? Dakord.
Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 15. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Po.
Komisioni për buxhet? Po.
Komisioni për komunitete? Po.

Vë propozimin në votim.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 16. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Po.
Komisioni për buxhet? Po.
Komisioni për komunitete? Po.

Vë propozimin në votim.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 15 abstenojnë.

Amendamenti 17. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Pajtohet.
Komisioni për buxhet? Po.
Komisioni për komunitete? Po.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 deputetë.

Amendamenti 18. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Po.

Komisioni për buxhet? Po.

Komisioni për komunitete? Po.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 deputetë.

Amendamenti 19. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Po.

Komisioni për buxhet? Po.

Komisioni për komunitete? Po.

Vë në votim propozimin.

Kush është për këtë propozim? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 15 deputetë.

Amendamenti 20. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 16 deputetë.

Amendamenti 21. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.
Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për këtë propozim? Shumica.
Kush është kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 15 deputetë.

Amendamenti 22. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.
Komisioni për buxhet? Dakord.
Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për këtë propozim? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 16 deputetë.

Amendamenti 23. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.
Komisioni për buxhet? Dakord.

Urdhëroni, ka sqarim nga Komisioni për buxhet. E ka fjalën Haki Shatri.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit. Komisioni për buxhet ka përkrahur këtë amendament, por pasi kemi marrë materialin është pa se fjalia, ashtu si është dhënë, nëse mbetet do të ketë implikime buxhetore, prandaj po propozoj që fjalia te pika 8.3. e amendamentit në fjalë të riformulohet dhe të jetë: "Fondi do të financohet prej buxhetit të konsoliduar të Kosovës, të miratuar nga Kuvendi dhe do të përfshijë: (mbesin burimet e njëjta të fondit). Ky është, domethënë, rregullimi i fjalisë i cili sqaron një punë që do të kishte implikime buxhetore dhe pika d) mbi 8.3., aty ku është "ministri" të jetë "qeveria". Domethënë, të fshihet "ministri" e të mbetet "qeveria". S'di pse na është përvjedhur kjo. Besoj se Komisioni funksional është pajtuar në diskutim kështu, por mbete që unë të dalë në formë komenti para jush. Ju falemnderit.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Megjithatë, i jipet fjala Komisionit funksional për të paraqitur qëndrimin e tyre.

(Flet prej vendit, nuk dëgjohet)

Nëse s'e keni dëgjuar mirë, Komisioni funksional konstaton se vërejtja e propozuar nga përfaqësuesi i Komisionit për buxhet mund të aprovohet sepse është një lëshim teknik.

Cili është qëndrimi i Komisionit për komunitete? Nuk ka vërejtje nga Komisioni për komunitete?

Prandaj, vë në votim propozimin e amendamentit që keni marrë me vërejtjet që u theksuan, me vërejtjen time se vërejtja që u dha është e vonshme dhe nuk është krejtësisht në rregull, por meqë jemi dakord të gjithë, atëherë e hedhim si të tillë në votim.

Kush është për këtë propozim? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 13 deputetë abstenojnë.

Për hirë të rregullsisë edhe në procedimin e mëtejshëm të herave tjera, megjithatë është e nevojshme që vërejtjet të dorëzohen me kohë me shkrim, në mënyrë që deputetët të kenë kohë edhe për t'i krahasuar dhe për të ndërtuar qëndrimin e tyre me kohë. Vazhdojmë me amendamentin vijues.

Amendamenti 24. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional çfarë qëndrimi ka? Dakord.

Komisioni për buxhet? Po.

Komisioni për komunitete? Po ashtu.

Vë propozimin e amendamentit në votim.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 13 deputetë abstenojnë.

Amendamenti 25. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.

Komisioni për buxhet? Po.

Komisioni për komunitete? Po ashtu.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 13 deputetë përsëri.

Amendamenti 26. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për këtë propozim? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 13 deputetë përsëri.

Amendamenti 27. Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Komisioni funksional? Dakord.

Komisioni për buxhet? Dakord.

Komisioni për komunitete? Dakord.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

Deputeti Kërstović e kërkon fjalën.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Dakle, ja kao predsjedavajući Komisije za prava i interese zajednica mogu da kažem da mi zaista nemamo nikakve primedbe ni na amandmane koji su podneti tako da ćemo stalno, kad nas predsjedavajući pita -- govoriti da i dati potpunu saglasnost. Ali hoću nešto da objasnim, malo sam zloupotrebio govornicu, hoću da kažem ovo što se dešava u Koaliciji «Povratak». Mi u principu nismo protiv zakona, da se razmemo, i ne vršimo nikakvu opstrukciju jer stalno glasamo kao uzdržani, ne glasamo protiv a to je zbog toga što nismo imali vremena da se bavimo Zakonom. Bavili smo se nekim drugim stvarima da bi smo došli ovde u ovaj Parlament. Na kraju, mi ćemo uzdržano glasati i kada je u pitanju ceo Zakon, ali ja hoću još jednu stvar da napomenem. Ja bih molio Skupštinu, molio bih predsjedavajućeg da povede računa kada se bude glasalo o Zakonu u celini, da li će danas moći da se glasa o Zakonu u celini ili je potrebno da se napravi integralni tekst Zakona pa da se o Zakonu u celini glasa na narednoj sednici, što mislim da je i praktično i u duhu sa prošlim poslovnikom i mislim da je u duhu i sa Ustavnim okvirom i Poslovnikom koji se sada primenjuje. Teško je da će... Ja mislim da neće moći danas da se glasa o Zakonu ako nemamo integralni tekst Zakona u rukama. Hvala lepo. Oprostitet, ja ću morati da izadjem još nekoliko puta...

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

E falënderojmë deputetin. Edhe pse ishte në kohën kur ne po votonim, por meqë u kërkua falje, duhet të ketë mirëkuptim. Vërejtjen do ta marrim parasysh. Mund të bisedojmë në fund kur të vendosim për të votuar për të, por tani, nëse jeni dakord vazhdojmë me procedurën që kishim në rrydhë. Jemi te amendamenti 27. Shumica janë deklaruar për. Kundër nuk kishte.

A abstenon ndokush nga votimi? 12 deputetë abstenojnë.

Meqë, në emër të Komisionit për komunitete u deklarua se nuk ka vërejtje në të gjitha amendamentet, a mund të konsiderojmë se kjo është përgjigje, do të thotë amblok për të gjitha amendamentet edhe prej komisioneve të tjera, ju lutem shprehimisht. Do të thotë qëndrimi është i njëjtë nga ai që kemi në letër.

Atëherë, vë në votim amendamentin 28.

Kush është për këtë propzim? Shumica.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 11 deputetë abstenojnë.

Amendamenti 29.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 11 deputetë abstenojnë.

Amendamenti 30.

Vë në votim propozimin.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 11.

Amendamenti 31.

Kush është për? Shumica.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 11.

Amendamenti 32.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 11.

Amendamenti 33.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 11.

Amendamenti 34.

Kush është për? Shumica.
A ka kush kundër? Askush.
A abstenon ndokush nga votimi? 11.

Urdhëroni, Sllobodan Bijeliq e ka fjalën.

SLOBODAN BIJELIĆ:

Oprostite, gospodine predsedavajući, članovi Skupštine, beležio sam vreme po kome radimo i ako budemo ovako nastaviti treba nam 105 minuta do kraja i zbog toga imam jedan predlog, mislim da nije u suprotnosti sa Poslovníkom, a to je: imamo dve grupe amandmana, prva grupa amandmana je podržana od znači strane glavnih komisija i funkcionalnih komisija i to su sve amandmani sa izuzetkom broja 31, 56 i 83 a ti amandmani su samo podržani od Komisije za budžet. Ako neko eventualno ima nešto da doda još neka kaže a ako ne, ja predlažem da na ovakav način odradimo i mislim da je sve u skladu sa Poslovníkom, da bi bili efikasniji. Mislim da je dobro da predsedavajući kaže amandman 35, 36, 37 i tako dalje, sa izuzetkom ovih i onda ćemo o njima ili ako nešto neko drugi ima onda da radimo tako. Ništa se neće bitnije izmeniti, ja se izvinjavam. Hvala.

KRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë. Është Kuvendi që vendosë për këtë. Ne kemi një Rregullore sipas të cilës punojmë. Megjithatë, amendamentet sipas rregullit aprovohen një për një dhe mendoj se më mirë është të humbim pak kohë por të përfitojmë në kohë me tempon që do të punojmë sesa t'i aprovojmë amendamentet amblok. Por, fundi i fundit vendosni ju, meqë ka një propozim dhe unë mund ta vë propozimin në votim.

Kush është pra që të votohet bashkërisht për amendamentet që mbështeten prej të gjitha komisioneve? Është shumica.

Kush është kundër? Një kundër.

Kush abstenon? Abstenojnë megjithatë një numër i vogël.

Atëherë për komisionet, lus Sekretarinë që t'i shënojë, në të cilat tri komisionet: Komisioni funksional, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për komunitete kanë qëndrim të njëjtë dhe rikonfirmojnë këtu se kanë qëndrim të njëjtë, atëherë të votojmë, do të thotë, në blok. Dhe këto amendamente janë, nëse gabo, më korrigjoni, ju lutem:

Amendamentet: 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83.

Praktikisht, të gjitha amendamentet që janë në listën e amendamenteve ju janë shpërndarë.

Meqë ne u përcaktuam të votojmë në këtë mënyrë dhe nuk ka asnjë vërejtje nga përfaqësuesit dhe deputetët, atëherë vë në votim aprovimin e të gjitha këtyre amendamenteve që u përmendën.

Kush është për?

A ka kush është kundër?

A abstenon ndokush nga votimi? Abstenuan 11.

Me saq përfundoi shqyrtimi dhe votimi i amendamenteve të propozuara.

Mos ka mbetur ndonjë amendament i papërfshirë në procedurë? Jo.

Atëherë vë në votim Ligjin në tërësi.

Sipas të dhënave nga shërbimi, prezentë janë 72 deputetë dhe ekziston kuorumi i nevojshëm.

Kush është për Propozimligjin, me amendamentet e aprovuara? 60 deputetë janë për.

Kush është kundër? Një kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? 11 kanë abstenuar.

VOTIMI – GLASANJE – VOTED:	
Për - Za - For: -----	60
Kundër - Protiv - Against -----	01
Abstenuan - Uzdržanih - Abstained: -----	11

Konstatohet se Ligji është i aprovuar.

(Duartrokitje)

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – **Parashtrimi i pyetjeve të deputetëve.**

Sipas asaj që na është ofruar nga Zyra për parashtrësia dhe propozime, në afatin e paraparë është proceduar vetëm një pyetje dhe është sjell një përgjigje me shkrim nga ministri për ekonomi e financa në pyetjen e deputetit Ismajl Kurteshi. Përgjigja me shkrim u është shpërndarë deputetëve. Meqenëse përgjigja është marrë, atëherë me këtë konsiderohet e kryer edhe kjo pikë e rendit të ditës, sepse pyetje tjera deputetësh nuk ka.

Me kaq rendi i ditës i seancës së sotme u krye.

Ju njoftoj se për caktimin e mbajtjes së seancës së ardhshme do të njoftoheni me kohë, por në Kryesi jemi përcaktuar që në seancën e ardhshme të procedojmë edhe ndonjë nga ligjet që kemi në shqyrtim dhe po ashtu do ta shtrojmë në rend të ditës gjendjen në gjyqësi dhe çështjen e personave që konsiderohen të zhdukur e të pagjetur. Do ta bëjmë një plan dhe do t'ju informojmë me kohë.

Ju falemnderit për pjesëmarrje dhe me kaq seancën e konsideroj të mbyllur.

Seanca mori fund në orën 13,15.

RT/1-37